

KODI: D.I.2/ FISHA E DOKTORANTIT¹

Fisha e kandidatit Doktorat shërben për të informuar sa më shpejt dhe sa më saktë Këshillin e Profesorëve, si dhe stafin e brendshëm akademik në lidhje me fushën e kërkimit, temën dhe kontributin e kandidatit doktorant.

EMRI/MBIEMRI I KANDIDATIT:	PEDAGOGU UDHËHEQËS
TITULLI I TEMËS:	
<i>Tema e Projektit Doktorat</i>	
<i>Pyetja Kërkimore</i>	
<i>Objektivat e Studimit</i>	
<i>Metodologjia e Punimit</i>	
<i>Modeli teorik dhe Literatura ku bazohet</i>	
<i>Argumenti ose hipoteza/t e punimit.</i>	
<i>Fjalët Kyce.</i>	

¹ Shih shembullin bashkëlidhur.

Shembull

EMRI/MBIEMRI I KANDIDATIT: Dilaver Acar	PEDAGOGU UDHËHEQËS Prof. Mustafa Türkeş
TITULLI I TEMËS: Loja e Asimetrisë e Vendeve të Vogla: Rasti i Politikës së Jashtme të Shqipërisë	
<i>Tema e Projektit Doktorat</i>	
<p>Kjo tezë hulumton politikën e jashtme të Shqipërisë post-komuniste duke u bazuar në qasjet e vendeve të vogla.</p>	
<i>Pyetja Kërkimore</i>	
<p>Pyetja kryesore që shtron studimi është cilat janë vazhdimësitë e politikës së jashtme shqiptare në periudhën post-komuniste nga periudha e shtetformimit dhe e komunizmit? Kjo vazhdimësi do të hulumtohet kryesisht nën prizmin e marrëdhënieve të Shqipërisë me Fuqitë e Mëdha.</p>	
<i>Objektivat e Studimit</i>	
<p>Studimi ka tre objektiva: Së pari, të japë një analizë teorikë të politikës së jashtme të vendeve të vogla si dhe të asimetrisë në marrëdhënien mes një shteti të vogël dhe një Fuqie. Kjo analizë teorike do të aplikohet në rastin e aleancave të Shqipërisë me disa superfuqi që nga momenti I shpalljes së pavarësisë në 1912. Së dyti, tema synon të shpjegojë ‘dobësinë’ e shtetit shqiptar në politikën e tij të jashtme. Kjo analizë do të fokusohet në momentet e distancimit dhe thyerjes së marrëdhënieve më të ngushta, ose aleancave strategjike, me shtetet më të fuqishme në disa momente historike. Së treti, ky studim synon të na japë një tablo historike të politikës së jashtme të Shqipërisë duke u fokusuar te vazhdimësitë dhe ndërprerjet e aleancave strategjike me vendet më të fuqishme.</p>	
<i>Metodologjia e Punimit</i>	
<p>Punimi do të bazohet në analize arkivore të periudhës 1992-2012 si dhe intervista të thelluara me dy shtresa/nivele: me elita të përfshira në vendimarrje të politikës së jashtme dhe me eksperte të fushës.</p>	
<i>Modeli teorik dhe Literatura ku bazohet</i>	
<p>Tema ka një karakter të theksuar historik, por ajo bazohet dhe mbi literaturën e vendeve të vogla dhe ‘shteteve të dobëta’ në Marrëdhëniet Ndërkombëtare.</p>	
<i>Argumenti ose hipoteza/t e punimit.</i>	
<p>Argumenti kryesor i temës është që Shqipëria si një vend i vogël i ka përdorur në mënyrë strategjike aleancat me Fuqitë e Mëdha me synim kompensimin e dobësisë së saj strukturore.</p>	
<i>Fjalë Kyce:</i> Politika e Jashtme e Shqipërisë, Shtet i Dobët, Fuqi e Madhe, Aleancë Strategjike	